

Jozef Martini - Aleancat politike

Tuesday, 07 April 2015

Aleancat politike

Jozef Martini

Aleanca Politike

Jozef Martini

Sa herë afrohen zgjedhjet flitet për aleancat politike. Asnjëna prej tyre nuk bahet për interesa personale! Jo, nuk bahet për me pasë, simbas forcës apo territorit të kontrolluëm, rrishtë të madhe apo të vogël të tortës publike, shumë apo pak pushtet, poste të dorës së parë apo të dytë, rol kryeministrit, ministrit, zëvendësministrit apo kryebashkiakut, administrim tenderash në shifra të mëdhaja apo pak ma të vogla. Jo, e gjitha kjo orgji lëpimje pështymësh të hedhuna dje në shoqni shokësh të ndryshëm prej të sotmëve bahet vetëm e vetëm "për hatër të popullit". E gjitha kjo ndamje e re skuadrash në lojën makabre të futbollit me kryet e shqiptarit si top bahet vetëm e vetëm "për të mirën" e këtij të fundit. E betohen për këtë, bile tue pasë mirësinë mos me pretendue me i besue me sy mbyllë (e pse me i kerkue me mbyllë sytë një popullit qorr?!); tue mos u justifikue për të kundërtën që kanë ba e thanë dje (e pse me u justifikue për të djeshmen para një popullit pa kujtesë?!); tue mos tregue a ishin shpifësa dje apo ashtu e mendojshin vërtet kur shokët e sotëm vetë i akuzojshin si kriminelat e hajdutë (e pse me ia spjegue një popullit që nuk i len shije të keqe?!).

Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Politike ky term spjegohet kështu:

Aleancë Politike: Asht bashkimi i atyne që, të hypun në kurriz të popullit, betohen prej mjesit deri në darkë se e duen popullin me gjithë shpirt dhe janë gati me ba për të çdo sakrificë... përveçse me iu ulë prej kurrizit.

Grafika:

Fracisco Goya (1746-1828), Tu Que No Puedes, 1799.

